



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivery	06.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	3955/2022		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.530/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.530/2022 të datës 14.06.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publik në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht** si e bazuar ankesa A.nr.530/2022 e datës 14.06.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **Shfuqizohet** Vendimi Nr.947/2022 i datës 07.06.2022 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. **Obligohet** Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e sistemuar ankuesin në një pozitë të mesme drejtuese në Shërbimin Civil në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi [REDAKTUAR] me datë 14.06.2022 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar avokatit [REDAKTUAR] ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3454/2022 të regjistruar me numër A.nr.530/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.947/2022 i datës 07.06.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes të cilit vendim ankuesit i është refuzuar kërkesa për sistemim në pozitë të nivelit të mesëm drejtues në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 3454/2022 e datës 14.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.947/2022 i datës 07.06.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin A.nr.243/2022 i datës 18.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 1417/2022 e datës 16.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.04/2022 të datës 21.02.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Autorizimin e datës 27.04.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Akt emërimit e ankuesit të datës 09.10.2012; Akt emërimit e ankuesit te datës 18.01.2017; Vendimin me numër Nr.06/106 të datës 11.06.2019 lidhur me emërimit e ankuesit në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 03.06.2021; E-mailin zyrtar të datës 01.06.2021; Vendimin me numër 2111/21 te datës 03.06.2021 nga Ministri i Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; E-mailin e datës 03.06.2021; E-mailin zyrtar te datës 01.06.2021; Emailin zyrtar te datës 07.06.2021 lidhur me opinionin ligjor nga MAPL; Ankesën e ankuesit te datës 25.11.2021 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës; Vendimin me numër A.nr.967/2021 te datës 21.01.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës; Përgjigjen ne ankese te datës 04.04.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankuesit të datës 18.01.2017; Vendimin me numër Nr.53 të datës 09.07.2018 për caktimin e ankuesit në pozitën Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; Përgjigjen e datës 08.12.2020 me numër të referencës 230/2020 nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës; Njoftimin e datës 28.08.2020 nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me pozitën e kategorisë së lartë drejtuese; Vendimin me numër VK.nr.29/2022 të datës 27.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin e datës 18.01.2017 rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar me afat të pacaktuar në vendin e punës *Drejtor i Drejtoratit të Pronave të Paluajtshme*, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa sipas Vendimit me numër 06/106 të datës 11.06.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi është emëruar *Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës*, me mandat tre (3) vjeçar.

Ankuesi, përmes e-mailit të datës 01.06.2021 i është drejtuar udhëheqësit të drejtpërdrejtë, gjegjësisht Ministrin të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kërkesë për lirim të tij nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe kthimin, respektivisht emërimin e tij në pozitë të nivelit të mesëm drejtues respektivisht si *Drejtor i Drejtoratit të Pronave të Paluajtshme* të cilën pozite ankuesi e mbante para se të emërohej në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 03.06.2021 ka nxjerr Vendimin me numër të protokollit 2111/21 me të cilin ka aprovuar kërkesën e ankuesit për përfundimin e parakohshëm të mandatit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe njëherit është kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që të veproj konform kompetencave dhe akteve ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 22.11.2021 i është drejtuar njësisë përgjegjëse, gjegjësisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me kërkesë për sistemimin e tij në pozitë të mesme drejtuese, bazuar në Vendimin me numër të protokollit 2111/21 të datë 03.06.2021 të Ministrin të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe dispozitat e Ligjit për Zyrtaret Publikë. Ky i fundit në raport me kërkesën e ankuesit asnjëherë nuk kishte nxjerr akt administrativ, andaj ankuesi me datë 25.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli me datë 21.01.2022 ka nxjerr Vendimin A.nr.967/2021 dhe ka obliguar Drejtorin e DMZP-së që të trajtojë kërkesën e ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtaret Publikë.

Me datë 21.02.2022, zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike, ka nxjerr Vendimin Nr.04/2022 me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e ankuesit për emërim në pozitë të mesme drejtuese, me arsyetimin se me asnjë dispozitë të Ligjit për Zyrtaret Publikë nuk përcaktohet përfundimi i mandatit para kohe me kërkesë të nëpunësit civil, dhe se kërkesa e ankuesit për lirim nga detyra dhe kthim në pozitën e mëparshme konsiderohet dorëheqje nga detyra dhe DMZP nuk ka kompetencë për të vendosur për sistemim në pozitë me të ulët pasi që nuk kemi të bëjmë me përfundim të mandatit siç përcaktohet me dispozitat e paragrafit 7 të nenit 42 të Ligjit për Zyrtaret Publikë.

Kundër Vendimit Nr.04/2022 të datës 21.02.2022, ankuesi ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor kundër Vendimit Nr.04/2022 i datës 21.02.2022. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më

datë 18.05.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.243/2022 me të cilin ka aprovuar ankesën e datës 16.03.2022 të ankuesit duke e shfuqizuar Vendimin Nr.04/2022 të datës 21.02.2022 dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerr aktin administrativ.

Më datë 07.06.2022 Zëvendësuesja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ka nxjerr Vendim me Nr. 947/2022 përmes të cilin ka refuzuar kërkesën e datës 22.11.2021 të ankuesit me arsyetimin se me asnjë dispozitë të Ligjit për Zyrtarët Publikë nuk përcaktohet përfundimi i mandatit para kohe me kërkesë të nëpunësit civil, dhe se kërkesa e ankuesit për lirim nga detyra dhe kthim në pozitën e mëparshme konsiderohet dorëheqje nga detyra dhe DMZP nuk ka kompetencë për të vendosur për sistemim në pozitë me të ulët pasi që nuk kemi të bëjmë me përfundim të mandatit siç përcaktohet me dispozitat e paragrafit 7 të nenit 42 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.947/2022 të datës 07.06.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon që ky vendim është nxjerr si rezultat i shkeljeve të ligjit material sepse nuk ka arsyetuar gjendjen faktike dhe juridike për faktin se kërkesa e ushtruar me datë 01.06.2021 nuk mund të ketë efektin e dorëheqjes për faktin se mungon qëllimi për dorëheqje nga Shërbimi Civil nga ana e ankuesit, por baza e kërkesës dhe rrjedhimisht qëllimi ka qenë kthimi në pozitën e mëparshme të punës në nivelin e mesëm drejtues, e cila kërkesë është aprovuar në tërësi nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, respektivisht Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht analizojë dispozitat ligjore lidhur me kompetencat e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht duke iu referuar nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16 dhe nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstatoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore është kompetent për emërimin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues të cilëve ju mbaron mandati, fillimisht në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues dhe pastaj në pozitë të kategorisë së lartë profesionale.

Ndërsa lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, shqyrtoj Vendimin Nr.947/2022 të datës 07.06.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe si rrjedhojë ka konstatuar që ky vendim është nxjerr pa ndonjë arsyetim respektivisht konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, sepse ankuesi në kërkesën e tij të datës 01.06.2021,sa i përket ofrimit të dorëheqjes institucionit respektivisht eprorit të tij, nuk ishte konform dispozitave të ligjit të zyrtarëve publik dhe si e tillë edhe nuk është dashtë të trajtohet respektivisht aprovohet pasi nuk është organ kompetentë që vendosë për këtë çështje Ministri, sepse në bazë të nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet që: *"Nëpunësi civil njofton dorëheqjen me shkrim te Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ku ushtron detyrën, ose te njësia përgjegjëse në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese"*, si rrjedhojë nëse

ankuesi do të kishte dhënë dorëheqje ka qenë i obliguar që kërkesën të parashtronte tek njësia përgjegjëse për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese konkretisht tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, mbi këtë bazë nuk mund të konstatohet që ankuesi ka pasur synim të jap dorëheqje nga shërbimi civil, por veprimet administrative kanë qenë konform qëllimit që të emërohet në një pozitë të mesme drejtuese në shërbimin civil, sepse i vetmi organ kompetent për të miratuar dorëheqjen për kategorinë e lartë drejtues është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike respektivisht gabimisht ka konstatuar të njëjtën dhe mbi bazë të një konstatimi të gabuar ka aplikuar gabimisht edhe dispozitat ligjore me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.947/2022 të datës 07.06.2022 pasi që nuk ka trajtuar mbi bazë të legjislacionit të shërbimit civil çështjen e përmbushjes së kushteve ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit në Shërbimin Civil, sepse në kapitullin pestë (V) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rregullohet çështja e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, ndërsa me nenin 59 të këtij ligji, përcaktohen në mënyrë taksative mënyrat e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, duke përcaktuar se: "1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, përfundon si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirin nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj", në rastin konkret të ankuesit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore për përfundim të marrëdhënies së punës, sepse themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji siç parashihet me nenin 32 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqenëse nuk janë konsumuar asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuar me legjislacionin për zyrtarët publik për përfundimin e mandatit të ankuesit në shërbimin civil, ashtu si potencuam më lartë, nga se dorëheqja e ofruar nuk ishte dorëheqje nga shërbimi civil, por nga pozita e nivelit të lartë drejtues me qëllim që të vendoset në pozitë të nivelit të mesëm drejtues, fakti që ishte aprovuar nga eprori i drejtpërdrejtë në këtë rast Ministri nënkupton se veprimet e ankuesit në këtë procedurë administrative kanë qenë të koordinuara me Ministrin, mbi këtë qëllim përgjegjësia është e Ministrisë dhe Ministrit që ka aprovuar dorëheqjen me qëllim të sistemimit të ankuesit në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues, nga se ashtu ishte përmbajtja e kërkesës së dorëheqjes, ndërsa përkundër këtyre veprimeve administrative që ndërliken me dorëheqjen nga pozita e nivelit të lartë drejtues, siç kemi specifikuar më lartë se këto veprime administrative nuk janë në harmoni me nenin 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet që: "Nëpunësi civil njofton dorëheqjen me shkrim të Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ku ushtron detyrën, ose të njësia përgjegjëse në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese" rrjedhimisht sikur ankuesi të kishte ende mandat në pozitë të nivelit të lartë drejtues për shkak të procedurave administrative jo në përputhje me legjislacionin e zyrtarëve publik do të nënkuptonte anulim të procedurave sa i përket çështjes që lidhet me objektin e kësaj ankese, që nënkupton vazhdimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës atëherë në kuptim të këtij qëllimi meqenëse ankuesit mandati i rregullt si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i

ka përfunduar më datë 11.06.2022 sipas Vendimit me numër 06/106 të datës 11.06.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilin mandat e ka pasur për një periudhë tre (3) vjeçare, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se në këtë rast aplikohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale"* dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *"Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit të nivelit të lartë drejtues nga shërbimi civil, Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore është e obliguar që brenda afatit më të shkurtër kohor, të emërojë nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit profesional"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me vendimin Nr.947/2022 të datës 07.06.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB të lëshuar nga Zv. Drejtoresha për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik thekson faktin se përmbajtja e dispozitivit dhe arsyetimit të vendimit të atakuar të pasqyruar si më lartë në këtë vendim, bie ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara si në nenin 83 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji"* pasi që sipas vendimit të atakuar përmes kësaj ankese, statusi i garantuar i nëpunësit civil sipas kësaj dispozita ligjore i humbet, madje përmbajtja e vendimit të atakuar bie ndesh me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, nga se ankuesit sipas vendimit të atakuar me këtë ankese i cenohet e drejta e ruajtjes së statusit të fituar të nëpunësit civil.

Andaj, sipas vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Vendimi Nr.947/2022 i datës 07.06.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk përmban një trajtim merititor të çështjes kryesore që është objekt i kësaj ankese e që në rastin konkret është e rregulluar me dispozitat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë statusin e nëpunësve të shërbimit civil, rrjedhimisht ky vendim është në kundërshtim me frymën e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të këtij ligji, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit për sistemim në një pozitë të mesme drejtuese në Shërbimin Civil janë të bazuara.

Duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është i obliguar që ankuesin ta sistemoj në një pozitë të mesme drejtuese në shërbimin civil në pajtim me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit për kompensimin e pagave dhe beneficioneve të tjera nga data 03.06.2021 deri në zbatimin e këtij vendimi, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që ankuesi de facto nuk ka ushtruar pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës nga data 03.06.2021, sepse mos ushtrimi i kësaj detyre ka ardhur si rezultat i kërkesës së tij, andaj pretendimi është i pabazuar.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.530/2022, datë 06/07/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokatit
- ❖ Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- ❖ Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMShCK-së.

